

TLAS



SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 3 2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë
(TLAS)

Përsosja e Sistemit të Ndihmës Juridike Kusht për Rritjen e Aksesit në Drejtësi

Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Civil Rights Defenders

MISIONI I TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është regjistruar si organizatë jo fitimprurëse, e pavarur, me Vendimin Gjykatë Nr. 346, datë 18/12/2006, themeluar nga CAFOD UK.

TLAS ka filluar aktivitetin si program i Cafod Albania, që në vitin 1999 dhe vazhdon të ofrojë shërbim ligjor falas për kategoritë në nevojë për çështje civile.

Plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i tyre mbi të drejtat themelore të njeriut, nxitja e ndryshimeve të sistemit ligjor, në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-sociale të individëve dhe grupeve vulnerabël.

OBJEKTIVAT E TLAS

- Të ofrojë shërbime të plota ligjore për shtresat në nevojë të shoqërisë;
- Të sigurojë që njerëzit në nevojë të kenë më shumë akses në sistemin ligjor;
- Të ndërmarrë inisiativa për përmirësime në legjislacion, advokim dhe lobbying për realizimin e tyre;
- Të ndikojë në përmirësimin e qeverisjes, përmes përfshirjes së grupeve vulnerabël;
- Të botojë të dhëna mbi probleme të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut, që janë ndeshur gjatë trajtimit të rasteve të klientëve të TLAS.

BORDI DREJTUES

Av. Dashamir Kore
Av. Maksim Haxhia
Suzana Sakiqi
Shkëlqim Bozgo
Viktor Gumi

GRUPI KËSHILLIMOR

Av. Ardjana Fullani
Dr. Tefta Zaka
Av. Dashamir Kore
Av. Natasha Sheshi
Av. Perikli Zaharia

STAFI I TLAS

Dr. Rajmonda Bozo
Av. Vangjel Kosta
Av. Elton Lula
Dr. Elvira Dervishi
Av. Naureda Llagami
Migen Elmazaj
Av. Anisa Haxhiqaj
Av. Adrian Shega

Si mund të realizojmë regjistrimin e lindjes së fëmijëve duke shmangur procedurën gjyqësore?

Bazuar në parashikimet e ligjit Nr 8950 dt.10.10.2002 “Për Gjendjen Civile” si dhe në situatën aktuale në Shqipëri në lidhje me fenomenin e mosregjistrimit të lindjeve të shtetasve, të regjistrimit të vdekjeve, si dhe me procedura të tjera që janë derivat i çështjeve të “regjistrimit civil”¹, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), u përqëndrua me prioritet në ndihmën ligjore falas ndaj shtetasve në nevojë për regjistrimin e lindjeve, vdekjeve, transferimit të dokumenteve të gjendjes civile, martesave, etj. Për këtë qëllim TLAS ka zbatuar dhe ndjekur metodologjinë e mëposhtme:

1 Termi “Regjistrim Civil” nënkupton të gjitha regjistrimet e shtetasve që shoqërohen me ndryshime në gjendjen e tyre civile sic janë transferimet e lejeve të banimit, regjistrimi i divorceve, i martesave, i vdekjeve, i lindjeve, i ndarjeve të familjeve, etj.

a. ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta ligjore dhe paralogjore ndaj shtetasve në nevojë për regjistrimet civile: kryesisht për transferimet e lejeve të banimit, regjistrimin e divorceve, martesave, vdekjeve, lindjeve, ndarjeve të gjendjes civile të familjeve, etj.

b. ndërgjegjësimin e grupeve të synuara të TLAS për rëndësinë e regjistrimeve civile, shkaqet dhe pasojat që ndikojnë jo vetëm në legjitimitetin e identiteit ligjor të individit dhe



pjestarëve të familjes së tij, por edhe në përfshirjen e aksesin e tyre në skemën e përkujdesjes sociale dhe shëndetësore.

c bashkëpunimin dhe trajnimin e aktorëve të procesit duke përfshirë dhe punonjësit e zyrave të gjendjes civile, nëpunës të tjerë civilë të strukturave shtetërore për të krijuar kushte sa më të përshtatshme për një akses më të mirë dhe më të gjerë të grupeve dhe komuniteteve në nevojë për regjistrimet civile.



Kanë kaluar më shumë se dy vjetë që kur filloi zbatimi i ndryshimeve të Ligjit Nr. 8950, datë 10. 10. 2002 dhe TLAS gjatë gjithë periudhës ka ndjekur me shumë vëmendje monitorimin e procesit vecanërisht në zyrat gjendjes civile në Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier, etj.

Në kuadrin e këtij monitorimi, për të patur një vizion më të qartë përsituatën, TLAS ka thithur mendimet e punonjësve të zyrave të gjendjes civile, mendime të cilat u bazuan dhe në risinë që solli ndryshimi i ligjit për regjistrimet e lindjeve brenda afateve dhe jashtë afateve, në mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve nga këta punonjës, problemet që ata kanë hasur si dhe nevojën për trajnimin e mëtejshëm të tyre.

Zyrat e Gjendjes Civile mbajnë pjesën më të madhe të peshës përsa l përket regjistrimit të lindjeve. Regjistrimi i lindjeve në gjendjen civile nuk është vetëm një detyrim ligjor për shtetasit por është kusht parësor për

gëzimin e të drejtave dhe lirive personale, ekonomike, politike, shërbimet shëndetësore, arsimore. Sondazhi, tregon se ende ka një numër të konsiderueshëm lindjesh që klasifikohen në më shumë se 30% raste në vit për çdo punonjës të gjendjes civile, të cilat si pasojë e problemeve ligjore duhet të regjistrohen vetëm me anë të procedurës gjyqësore.



Pikerisht kjo shifer beri qe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile dhe ekspertet e TLAS te mblidhen dhe të shqyrtojnë nga afër rast pas rasti mënyrën e zgjidhjes së regjistrimit të rasteve me pasaktësi të lindjeve të paraqituara, duke synuar kur është e mundur shmangjen e procedurave gjyqësore. Udhëzuesi i përgatitur për këtë qëllim synon pikërisht ofrimin e modeleve të regjistrimeve të lindjeve me rrugë administrative. Duke u zbatuar ky udhëzues nga zyrat e gjendjes civile , numri i fëmijëve të paregjistruar sigurisht që do të zvogëlohet në mënyrë të ndjeshme, si rezultat redukto-

het gjithashtu numri i regjistrimit të lindjeve me rrugë gjyqësore. Përveç udhëzuesit të përgatitur nga ekspertet e TLAS janë identifikuar nga sondazhet edhe disa gjetje e rekomandime të cilat mendojmë se mund të vlejnjë në përmirësimin e shërbimit të gjendjes civile:

Rekomandime lidhur me aftësimin e punonjësëve të gjendjes civile dhe institucioneve shëndetësore;

1. Trajnim i personelit për zbatimin e procedurave në ofrimin e shërbimeve duke respek-



mënyrën e plotësimit të dokumentacionit përkatës (procesverbalit dhe çertifikatës së asistencës në lindje).

Rekomandime për lehtësimin e procedurave për shtetasit shqiptar që banojnë jashtë Shqipërisë.

tuar detyrimet e administratës shtetërore për të ofruar ndihmë ligjore në formë të informacionit ligjor dhe për t'u dhënë mundësinë shtetasve të realizojnë të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të tyre në rastet që i vlerësojnë të pabazuara në ligj.

2. Trajnim i personelit mbi etikën dhe deontologjinë. Standardet e komunikimit në ofrimin e shërbimit ndaj publikut (në veçanti me njerëzit në nevojë).

3. Trajnim i personelit të institucioneve shëndetësore që asistojnë lindjet, lidhur me

1. Të institucionalizohen procedurat përmes investimit të Ministrisë së Jashtme Shqiptare, e cila të ketë autoritetin dhe përgjegjësinë për pranimin e kërkesave dhe dokumentave që disponohen në mënyrë të pjesshme nga qytetarët që i kanë lindur fëmijët jashtë shtetit, kundrejt tarifave apo pagesave të kalkuluar dhe të angazhojë konsullatat me legalizimin e tyre në përputhje me shkallët procedurale.

2. Të informohen shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë Shqipërisë (veçanërisht në vendet fqinje ku është më i lartë numri i emigrantëve) nga vetë ambasadat dhe zyrat konsullore shqiptare, apo pranë pikave

kufitare mbi kërkesat e ligjit për regjistrimin e lindjeve dhe formën mbi vlefshmërinë e dokumentave të shteteve të huaj për tu përdorur në Shqipëri.



RASTE TË NDRYSHME TË REGJISTRIMIT TË FËMIJËVË NË ZYRËN E GJËNDJES CIVILE

Rasti 1

A. bashkëjeton me B. dhe është në pritje të lindjes së një fëmije. Ajo nuk ka lidhur martesë ligjore dhe në gjëndjen civile figuron “beqare”. Kur u shtrua në maternitet për të lindur fëmijën, nëna nuk dispononte dokument zyrtar identifikimi (letër- njoftim, pasaportë apo ndonjë dokument tjetër). Në intervistën për përcaktimin e identitetit të saj, ajo deklaroi emrin e saj të saktë dhe si mbiemër deklaroi atë të B. (duke e pretenduar atë si bashkëshort, për shkak të bashkëjetesës dhe të faktit që ai ishte babai i fëmijës që po lindte.

A mundet nëna t’a regjistrojë fëmijën në këtë rast?

Sipas nenit 38 të Ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjëndjen civile”:

“1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.

2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.

3. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes”.

Në kushtet që ndërmjet dokumentit “çertifikatë asistence në lindje” dhe dokumentit identifikues të nënës, që pretendon të

ketë lindur fëmijën, ka mospërputhje të identitetit, vihet në dyshim vetë fakti, që kërkohet të regjistrohet, pra fakti që nëna pretenduese të ketë lindur fëmijën. Nëse ndërmjet dokumentave të mësipërme nuk ka përputhje në identitetin e nënës që, sipas çertifikatës së asistencës së lindjes ka lindur fëmijën dhe, personit që paraqitet për të regjistruar fëmijën si të vetin ka ndryshime në të dhënat e identitetit, nuk mund të pranohet kërkesa për regjistrimin e fëmijës si fëmijë e lindur nga kjo nënë.

KUJDES! Të dhënat që identifikojnë një individ janë të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit Nr. 10129. Mospërputhja që u trajtua më sipër, ndërmjet të dhënave të gjëndjes civile të nënës- kërkuese për regjistrimin e lindjes së fëmijës dhe nënës që ka lindur fëmijën, sipas çertifikatës së asistencës në lindje, duhet të jenë qartësisht të ndryshme që të tregojnë ekzistencën e dy personave të ndryshëm.

Praktika e TLAS tregon se ka raste kur çertifikata e asistencës

në lindje është qartazi e nënës që kërkon të regjistrojë lindjen e fëmijës, por në të ka të pasqyruar të dhëna të cilat “janë tepër” pasi nuk i përkasin këtij dokumenti. Kështu, sipas nenit 9 të Ligjit 10129 vetëm “amësia” përbën fakt të rrjedhur nga ngjarje natyrore (pra që vërtetohet me çertifikatën e asistencës në lindje), ndërsa atësia (sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 10129) përbën një fakt të prezumuar apo të përcaktuar nga veprimet e vetë personit.

Një çertifikatë e asistencës në lindje, që nuk i ka të plotësuarat qartësisht të dhënat e nënës që ka lindur fëmijën, mund të kërkohet të plotësohet me të dhënat e plota nga organi që e ka lëshuar atë, pra nga institucioni i lindjes së fëmijës. Në këto raste, punonjësi i zyrës së gjëndjes civile ka detyrim ligjor që t’i caktojë afat (me shkresë) kërkuesit për regjistrimin e lindjes, duke i kërkuar të plotësojë të metat e çertifikatës së asistencës së lindjes, duke ja sqaruar të metat që gjenden në këtë dokument. Për të qenë më konkret, nëse në

një çertifikatë asistencë lindje është shënuar edhe “atësia” e fëmijës së lindur apo nëna është e shënuar me dy mbiemra (në rastin tonë të vajzërisë dhe të personit me të cilin bashkëjeton), ky dokument nuk mund të refuzohet, për të realizuar kërkesën për regjistrimin e fëmijës, pasi ai përcakton qartësisht të dhënat e domosdoshme, që duhet të përmbajë, pra, faktin e lindjes së një fëmije, kohën e lindjes, vëndin e lindjes, seksin e fëmijës, identitetin e nënës që ka lindur, identitetin e personelit shëndetsor që vërteton këtë fakt (lindjen).

Rasti 2

A. bashkëjeton me B. prej vitesh, pa lidhur martesë ligjore me të. Gjatë kohës së bashkëjetesës, gruaja ka lindur një fëmijë. Kur ka lindur fëmijën në materitet, ajo ka dhënë saktësisht emrin e saj dhe të babait të fëmijës. A. dëshiron që fëmija të marrë atësinë e të atit.

1. Si duhet të veprojë nëpunesi për regjistrimin e fëmijës ?

Në këtë rast, nëna do ta regjistrojë fëmijën në zyrën e gjëndjes civile ku është regjistruar familja e saj dhe punonjësi i gjëndjes civile në aktin e lindjes do të plotësojë vetëm rubrikat që i takojnë nënës dhe do të lërë pa plotësuar rubrikat që i takojnë babait, dhe fëmijës do ti vendoset si mbiemër ai i nënës.

2. Si duhet të veprohet që fëmija të marrë atësinë?

Ligji Nr. 10129 përcakton ndarjen në « përbërës të gjëndjes civile që rrjedhin nga ngjarje natyrore » (neni 9) dhe «përbërës të prezumuar ose të rrjedhur nga veprimet e vetë personit » (neni 10).

Ndërsa « amësia » bën pjesë në përbërësit e grupit të parë, pra përbërës që rrjedh nga një ngjarje natyrore, siç është lindja e fëmijës dhe që provohet me proces verbalin, që mbahet në momentin e ndodhjes së ngjarjes (më i zakonshmi është çer-

tifikata e asistencës në lindje), « atësia » bën pjesë në grupin e dytë, pra të përbërësve të prezumuar ose të përcaktueshëm nga veprimet e vetë personit.

Sipas nenit 180 të Kodit të Familjes:

"Fëmija që ka lindur gjatë martesës prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës.

Fëmija që ka lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës ose nga shpallja e pavlefshmërisë së martesës prezumohet se ka për atë ish-bashkëshortin e nënës.

Kur fëmija ka lindur gjatë vazhdimit të martesës së dytë të nënës, prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës me martesë të dytë, edhe sikur fëmija të ketë lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës së parë ose nga shpallja e pavlefshmërisë së saj."

Nga dispozita e sipërcituar është e qartë se në rastet kur fëmija lind nga një nënë, e cila plotëson kriteret e mësipërme (e martuar, me martesë të zgjidhur, me martesë të shpallur të

pavlefshme) ndodhemi para rastit të përcaktimit të përbërësit të gjëndjes civile "atësia", mbi bazën e prezumimit, ndërsa kur fëmija lind nga një nënë e pamartuar ndodhemi para rastit të caktimit të përbërësit të gjëndjes civile sipas "veprimeve të vetë personit".

Në rastin që po trajtohet, veprimet e vetë personit janë përcaktuar në nenin 181 të Kodit të Familjes. Sipas kësaj dispozite, "Atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njeh fëmijën si të tij.

Njohja e atësisë është e vlefshme, kur për këtë jep pëlqimin nëna e fëmijës, të cilën e lajmëron nëpunësi i gjendjes civile. Kur nëna e kundërshton këtë njohje ose nuk përgjigjet brenda 1 muaji nga marrja e lajmërimit, burri që ka njohur fëmijën si të tij mund të ngrejë padi para gjykatës kompetente, për të vërtetuar se ai është i ati i fëmijës."

Pra, në rastin konkret, nëna dhe babai pretendues i fëmijës duhet

të paraqiten në zyrën e gjëndjes civile të pajisur me dokumente identifikimi, t'i dorëzojnë punonjësit të gjëndjes civile çertifikatën e asistencës në lindje dhe duhet të deklarojnë atësinë e fëmijës përpara punonjësit të gjëndjes civile. Punonjësi plotëson rubrikat e aktit të lindjes me të dhënat e plota të dy prindërve dhe mban procesverbalin përkatës të nënshkruar nga të dy personat e mësipërm.

3. Në cilën zyrë të gjëndjes civile duhet të regjistrohet fëmija?

Fëmija mund të regjistrohet ose në zyrën e gjëndjes civile të nënës, ose në atë të të atit. Në këtë rast procesverbali i njohjes së atësisë së fëmijës duhet të përmbajë edhe vullnetin e prindërve për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, pra në cilën familje do të bëjë pjesë fëmija meqë prindërit paraqiten të veçuar në dokumentacionin e gjëndjes civile.

Nëse prindërit nuk bien dakord, fëmija detyrimisht duhet të regjistrohet pranë nënës.

Rasti 3

A. (nëna) dhe B. (babai) kanë bashkëjetuar për një kohë të caktuar. Gjatë periudhës së bashkëjetesës, A. ka lindur një fëmijë. Fëmija lindi në kushte spitalore dhe mbas daljes nga spitali, nëna u pajis me çertifikatën e rregullt të asistencës në lindje të fëmijës. Për arsye të ndryshme, A. dhe B. nuk e regjistruan fëmijën në gjëndjen civile. Për shkak të grindjeve të përsëritura, nëna (A.) u largua nga banesa e përbashkët, ndërsa fëmija vazhdoi të jetojë në të njëjtën banesë, pra në banesën e B. Në kohën që babai vendosi të regjistrojë fëmijën, u paraqit në gjëndjen civile me çertifikatën e asistencës në lindje, ku ishin të shënuara rregullisht emrat e nënës dhe babait.

Amundet që punonjësi i gjëndjes civile ta regjistrojë këtë fëmijë me kërkesën e të atit pretendues, pa praninë e nënës?

Neni 40 i Ligjit Nr. 10129 përcakton se:

“1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme”.

Në rastin e shtruar për diskutim, duhet të sqarojmë termin “prindër” sipas dispozitës së sipërcituar. Në rastet e mëparshme kemi sqaruar ndarjen e përbërësve të gjendjes civile në “përbërës që rrjedhin nga ngjarje natyrore” (neni 9) dhe “përbërës të prezumuar ose të rrjedhur nga veprimet e vetë personit” (neni 10).

Meqë në rastin që po trajtohet, nëna nuk ka qënë e martuar në momentin e lindjes, nuk mund të përcaktohet ati i fëmijës nëpërmjet “prezumimit” (neni 180 i Kodit të Familjes). Për rrjedhojë, atësia e fëmijës mund të caktohet vetëm pasi të realizohet procedura e “njohjes së atë-

sisë” sipas nenit 181 të Kodit të Familjes apo me procedurë gjyqësore nëpërmjet “vërtetimit të atësisë”, sipas neneve 181 – 183, 189 – 191 të Kodit të Familjes. Deri në përfundim të këtyre procedurave fëmija konsiderohet “pa atësi”. Në këtë situatë, në momentin e regjistrimit të fëmijës, personi që ka bashkëjetuar me nënën e fëmijës, ndonëse e pretendon veten si at të fëmijës, ende nuk është “de jure” i tillë. Pra, ai nuk mund të konsiderohet ende “prind” i fëmijës dhe si i tillë nuk mund të kërkojë regjistrimin e tij.

Për të realizuar procedurën e regjistrimit të fëmijës mund të kërkohet bashkëpunimi i subjekteve që legjitimon dispozita e mësipërme. Pjestarë madhorë të fëmijës (anëtarët e familjes së nënës), personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen.

Rasti 4

A. është shtatzanë dhe jeton në një fshat të thellë të zonës, ku nuk ka shërbim shëndetësor

spitalor. Ajo është e martuar. Për shkak se nëna nuk pati mundësi që të shkojë në qendrën më të afërt spitalore, fëmija lindi në shtëpi dhe gjatë lindjes nëna u ndihmua nga mamia e fshatit. Mbas njëfarë kohe, A. u paraqit në zyrën e gjëndjes civile për të regjistruar fëmijën.

A mund ta regjistrojë punonjësi i gjëndjes civile këtë fëmijë, cilët janë dokumentat që kërkon Ligji për këto raste ?

Sipas nenit 38 të Ligjit Nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjëndjen civile”:

“1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm...”.

Pra, vetë ligji ka parashikuar mundësinë e lindjes së një fëmije jashtë institucioneve shëndetësore të specializuara për

lindjen e fëmijëve. Në rastet e mëparshme është sqaruar përmbajtja e ligjit i cili, duke e konsideruar lindjen një ngjarje natyrore, kërkon vetëm “garancitë e nevojshme”, që të vërtetohet ky fakt, pra lindja e fëmijës, seksi, koha, vëndi, identiteti i nënës që e ka lindur. Për rrjedhojë, termi “raport mjekësor ose procesverbal i hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm...” duhet të kuptohet drejt dhe jo në mënyrë kufizuese.

Në këto raste, termii “pranishëm” nuk duhet ngushtuar vetëm me rastin kur mamia është fizikisht e pranishme në çastin e lindjes së fëmijës, por edhe kur ajo merr informacionin e nevojshëm për të vërtetuar faktin e mësipërm, pra që A. ka lindur fëmijën, në prani të familjarëve të saj dhe ajo është vënë në dijeni dhe ka vizituar atë menjëherë pas lindjes, duke u përkujdesur për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Në këto raste, nëse nga personat e pranishëm në lindje mbahet një procesverbal, që vërteton faktin e mësipërm dhe ky procesverbal

konfirmohet nga një personel mjekësor kompetent, dokumentat janë të mjaftueshëm për të realizuar regjistrimin e lindjes së fëmijës mbi kërkesën e nënës (apo një personi të përcaktuar nga neni 40 i Ligjit).

Rasti 5

Nëna A. duke qenë shtatzënë, së bashku me disa persona të tjerë të familjes, u nis për të kaluar kufirin në mënyrë ilegale, për të shkuar jashtë shtetit. Gjate rruges ajo e lindi fëmijën e saj, me ndihmën e familjarëve. Grupi i tyre mundi ta kalojë kufirin dhe ata qëndruan jashtë shtetit për disa muaj, derisa i kthyen në Shqipëri, në mungesë të lejeqëndrimit. Me t'u kthyer në atdhe, A. u paraqit në zyrën e gjëndjes civile dhe i kërkoi punonjësit të gjëndjes civile që të regjistronte fëmijën e saj.

**Çfarë dokumentash do të reko-
mandoni që të plotësojë nëna
dhe çfarë ruge duhet të ndjekë
ajo për të regjistruar fëmijën?**

Duke patur parasysh trajtimin e hollësishëm në Rastin 4, është e domosdoshme që të sqarohen sa më mirë rrethanat konkrete të lindjes. Një nënë në ato kushte ka shumë mundësi që të ketë kontaktuar një personel mjekësor të vendit ku ka ngjarë lindja për të kërkuar ndihmë shëndetsore. Nëse ky fakt vërtetohet duhet orientuar kërkuesja (nëna), që të plotësojë dokumentat që kërkon ligji, duke plotësuar procesverbalin përkatës dhe konfirmimin nga personeli mjekësor që ka vizituar nënën dhe fëmijën pas lindjes.

Sipas paragrafit të dytë të nenit 38 të Ligjit Nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjëndjen civile”:

2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.

Pra, ligji ka ngushtuar në mënyrë të dukshme nevojën e procedurave gjyqësore për të vërtetuar faktin e lindjes vetëm me

mungesën e dokumentave që e vërtetojnë këtë fakt nga të pranishëm dhe personeli mjekësor që mund të konfirmojë faktin e lindjes. Përvoja e TLAS tregon se jo rrallë, rastet e lindjeve nuk trajtohen sipas frymës së ligjit dhe u rekomandohet personave – kërkues, që të ndjekin procedura gjyqësore për regjistrimin e lindjes edhe në kushtet që ajo nuk është e nevojshme.

Pra, procedura gjyqësore parashikohet nga ligji si përjashtim, për shkak të mungesës së dokumentave dhe jo si procedurë e zakonshme për regjistrimin e fëmijëve.

Rasti 6

Shtetësja A. bashkëjeton prej vitesh me B. Në gjëndjen civile ajo figuron e martuar me shtetasin C., me të cilin ka edhe 3 fëmijë të regjistruar në gjëndjen civile. A, është shtatzënë dhe pret fëmijën e saj të katërt. Ajo ka mbetur shtatzënë gjatë periudhës që bashkëjetonte me B, për të cilin pretendon se është

babai biologjik i fëmijës . Nisur nga rrethanat e mësipërme, ajo ka deklaruar në maternitetin si at të fëmijës, personin me të cilin bashkëjeton, pra B.

Si do të regjistrohet ky fëmijë?

Çështja e parë që shtrohet për shqyrtim lidhet me dokumentin për regjistrimin e fëmijës.

Në Rastin 1 është sqaruar se kur nuk mund të përdoret çertifikata e asistencës në lindje. Nëse një dokument i tillë përmban qartësisht të përcaktuar faktet që përcakton Ligji nr. 10129, pra faktin e lindjes, vëndin e lindjes, kohën e lindjes, seksin e fëmijës së lindur, identitetin e nënës që ka lindur fëmijën dhe identifikimin e personelit mjekësor që konfirmon faktet e mësipërme, dokumenti është i vlefshëm për t'u përdorur për regjistrimin e fëmijës edhe sikur ky dokument të përmbajë të dhëna shtesë të cilat nuk janë pjesë përbërëse e tij. Pra, ndonëse në këtë dokument është shënuar, mbi deklarimin e nënës edhe emri i atit të fëmijës, i cili

nuk është bashkëshorti i nënës, dokumenti është i përdorshëm për qëllimin ligjor për të cilin kërkohet mbajtja e tij. Pra, çertifikata e asistencës së lindjes përfaqëson një dokument të vlefshëm për regjistrimin e lindjes së fëmijës në këtë rast.

Çështje tjetër e rëndësishme në këtë rast, lidhet me atësinë me të cilën do të regjistrohet ky fëmijë.

Është sqaruar edhe më lart se, “atësia” është përbërës i prezumuar ose që lidhet me veprimet e vetë personit.

Neni 180 i Kodit të Familjes përcakton qartë se në këtë rast ati i fëmijës prezumohet, pra edhe do të regjistrohet bashkëshorti i nënës, pra shtetasi C. Kjo situatë duket “absurde” pasi në të është sqaruar fakti se A, ka vite që nuk bashkëjeton më me bashkëshortin e saj C. Por duhet mbajtur parasysh fakti se, nga njëra anë kjo situatë absurde është rrjedhojë e sjelljes së vetë subjekteve të mësipërm, që kanë lejuar një situatë të pazakontë, sipas së

cilës ndërsa A, është e martuar me C, bashkëjeton me një person tjetër jo-bashkëshort, me shtetasin B.

Edhe për këto situata ligji ka parashikuar mundësi ligjore për të rregulluar situatën faktike.

Kodi i Familjes parashikon procedurë ligjore, nëpërmjet të cilave atësia e prezumuar mund të hiqet, duke hapur rrugën procedurave gjyqësore për regjistrimin e atit biologjik (të vërtetë) si të tillë (nenet 184 – 186 të Kodit të Familjes).

Rasti 7

Shtetësja A, banon jashtë Shqipërisë. Në kohën që banonte në shtetin e huaj, ajo lindi një fëmijë. Me dokumentin e lëshuar nga shtëpia e lindjes ajo kërkon të realizojë regjistrimin e fëmijës në zyrën e gjëndjes civile në Shqipëri, ku ka edhe regjistrimin e saj.

Si do të realizohet regjistrimi i fëmijës?

Sipas nenit 41 të Ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjëndjen civile”:

1. *Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.*

2. *Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.*

3. *Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare, në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.*

Nga përmbajtja e dispozitës, mund të krijohet përshtypja e pasaktë, sipas së cilës regjistrimet e fëmijëve të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të realizohen

vetëm pranë zyrave të gjëndjes civile jashtë Shqipërisë, pra në përfaqësitë diplomatike, konsullore apo në zyrat e shërbimit të gjëndjes civile të vendit përkatës.

Por, nëse vlerësojmë dispozitën sipas qëllimit për të cilin është formuluar, do të shohim qëllimin e vërtetë të saj, që është lehtësimi i procedurave të regjistrimit të fëmijëve të lindur nga shtetas shqiptarë, që banojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Formulimet e natyrës “..edhe në...”, tregojnë qartë se qëllimi i ligjvënësit është që të shtojë mundësitë e regjistrimit të fëmijëve, në sa më shumë alternativa të mundshme, me synimin për të krijuar hapësira të gjëra të regjistrimit të fëmijëve. Në vazhdim të këtij komenti, në rastin konkret, nuk ka asnjë pengesë që të realizohet regjistrimi i fëmijës së lindur jashtë Republikës së Shqipërisë.

Në këto raste problem mbetet forma e dokumentit për të qenë i vlefshëm për regjistrim.

Në kushtet që bëhet fjalë për një dokument të lëshuar nga një organ që nuk është organ publik i Republikës së Shqipërisë, dokumenti duhet të plotësojë formën e vlefshme për t'u përdorur në Shqipëri, pra "legalizim" nga organet diplomatike apo konsullore ose vërtetim "apostille" nga vendet të cilat kanë aderuar në marrëveshjen ndërkombëtare përkatëse të Hagës.

Ky legalizim duhet të bëhet qoftë në Çertifikatën e Asistencës në Lindje, të lëshuar nga materniteti, qoftë në Çertifikatën e Gjëndjes Civile, të lëshuar nga zyra e gjëndjes civile jashtë shtetit.

Rasti 8

Shtetësja A, ka lindur fëmijë nga marrëdhënie jashtëmartesore. B, (i ati i fëmijës) deklaroi "njohjen vullnetare të fëmijëve" dhe nëna e pranoi këtë njohje vullnetare, fëmijët u regjistruan me atësi shtetasin B, i cili njohu vullnetarisht këta fëmijë si të vetët. Mbi kërkesën e të dy prindërve,

fëmijët u regjistruan në gjëndjen familjare të familjes së të atit, ndërsa nëna vazhdonte të figuronte në familjen e prindërvet të saj. Pas vdekjes së atit të fëmijëve, nëna kërkon që regjistrimi i fëmijëve të transferohet nga gjëndja civile familjare e të atit, në gjëndjen civile familjare të nënës.

A duhet të pranohet kërkesa e nënës për këtë transferim?

Në zbatim të neneve 220 dhe 227 të Kodit të Familjes, përgjegjësia prindërore ndaj fëmijëve të mitur ushtrohet nga prindërit.

Sipas nenit 227 të Kodit të Familjes:

"Përgjegjësia prindërore ndaj fëmijës së lindur jashtë martese ushtrohet nga prindi që e ka njohur fëmijën si të tij. Në qoftë se ai është njohur nga të dy prindërit, përgjegjësi në prindërore e kanë të dy prindërit...".

Sipas nenit 215 të Kodit të Familjes:

*“Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqënien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, **duke mbajtur raporte vetiake me të**, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij”.*

Në vazhdim, neni 218 i Kodit të Familjes shprehet se:

“Prindërit mund të kërkojnë nga gjykata kthimin e fëmijës së tyre të mitur, kur nuk jeton pranë tyre dhe mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë”.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme të Kodit të Familjes, është e qartë se edhe neni 16 i Ligjit nr. 10129 “Për gjendjen civile”, në kuptimin e “regjistrimit të familjes”, fëmijët janë pjestarë të familjes së nënës së tyre , kërkuases A, pasi për

shkak të mungesës së prindit tjetër, ajo është i vetmi prind që mund të ushtrojë përgjegjësinë prindërore, pra i vetmi prind që ka detyrim të bashkëjetojë me ta. Kështu, sipas nenit 16 të këtij ligji:

“3. Shtetasi i mitur, apo që i është hequr zotësia për të vepruar, ka vendbanim të njëjtë, sipas rastit, me atë të kryefamiljarit, prindit me të cilin jeton apo të kujdestarit të tij. Kur një i mitur apo një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, banon në një vendbanim të ndryshëm nga prindërit e tij, deklarimi për të, bëhet sipas rastit, nga kryefamiljari, njëri nga prindërit, apo personi që zotëron kujdestarinë. Në këtë rast, zyra e gjendjes civile administron edhe dokumentacionin që provon kujdestarinë mbi të miturin dhe vendbanimin e kujdestarit”.

Deri ditën e vdekjes së babait të tyre, fëmijët kishin të drejtë ligjore të ishin pjestarë të familjes së babait ose nënës së tyre, pasi sipas nenit 227 të Kodit të Familjes,

ndonëse janë fëmijë të lindur “jashtë martesës”, përgjegjësinë prindërore e ushtrojnë të dy prindërit që kanë njohur fëmijët, pra në rastin konkret si babai ashtu edhe nëna.

Në zbatim të kësaj dispozite (nenit 227 të Kodit të Familjes), pas vdekjes së babait të fëmijëve, përgjegjësinë prindërore e ushtron **vetëm nëna e tyre**, kërkuesja A. Si e tillë, si personi që ushtron i vetëm përgjegjësinë prindërore, ajo ka të drejtën dhe detyrimin që t'i mbajë në mënyrë vetiake fëmijët, pra të bashkëjetojë me ta, për aq kohe sa nënës nuk i është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate.

Në rastin konkret, çdo nëpunës që përballët me raste të tilla nuk duhet të diskutojë regjistrimin në trungun e nënës, edhe sikur për këtë të mos pranojnë pjesëtare të tjerë madhore që mund të jene në trungun e babait të fëmijëve.



Ç'NJOHJA E ATËSISË (KUNDËRSHTIMI I ATËSISË)

Një nga konceptet më të rëndësishme që është parashikuar edhe në Kodin e Familjes është “Atësia”. Vetë termi Atësi përfshin a) njohjen e atësisë dhe b) ç’njohjen e atësisë.

Janë pikërisht rastet e njohjes së atësisë për fëmijët të cilët janë fryt i bashkëjetesës të cilat hasen më shumë në praktikën gjyqësore shqiptare.

Në këto raste ligji parashikon si procedurë faktin e paraqitjes së personit që kërkon të njihet

si atë i një fëmije të lindur jashtë martese me paraqitjen e tij pranë Zyrës së Gjendjes Civile të nënës dhe me deklarin e tij për atësinë e fëmijës si më poshtë:

Atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njeh fëmijën si të tij. Njohja e atësisë është e vlefshme kur për këtë jep pëlqimin nëna e fëmijës, të cilën e lajmëron nëpunësi i gjendjes civile. Kur nëna e kundërshton këtë njohje ose nuk përgjigjet brenda 1 muaji nga marrja e lajmërimit, burri që ka njohur fëmijën si të tij mund të ngrejë padi para gjykatës kompetente për të vërtetuar se ai është i ati i fëmijës.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti nga data e marrjes së lajmërimit nga nëpunësi i gjendjes civile, për mospranimin nga ana e nënës.

Pra një pjesë mjaft e rëndësishme e procesit është pëlqimi i dhënë nga nëna e fëmijës.

Pra, në rastin konkret, nëna dhe babai pretendues i fëmijës duhet të paraqiten në zyrën e gjendjes civile të pajisur me dokumente identifikimi, t’i dorë-



zojnë puno-njësit të gjëndjes civile çertifikatën e asistencës në lindje dhe duhet të deklarojnë atësinë e fëmijës përpara punonjësit të gjëndjes civile. Punonjësi plotëson rubrikat e aktit të lindjes me të dhënat e plota të dy prindërve dhe mban procesverbalin përkatës të nënshkruar nga të dy personat e mësipërm.

Një aspekt tjetër mjaft i rëndësishëm për të drejtën familjare shqiptare por që haset më rrallë në praktikën gjyqësore janë rastet e kundërshtimit të atësisë për fëmijët që lindin si rezultat i një marrëdhënie të ligjëruar me martesë ligjore.

Kodi i familjes në nenin 180 të tij shprehet se : Fëmija që ka lindur gjatë martesës prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës. Fëmija që ka lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës ose nga shpallja e pavlefshmërisë së martesës prezumohet se ka për atë ish-bashkëshortin e nënës. Kur fëmija ka lindur gjatë vazhdimit të martesës së dytë të nënës,



prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës me martesë të dytë, edhe sikur fëmija të këtë lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës së parë ose nga shpallja e pavlefshmërisë së saj.

Në këtë rast ndodhemi përpara prezumimit ligjor përsa i përket atësisë dhe amësisë së fëmijëve, sidomos përsa i përket atësisë pasi është një proces mjaft delikat.

Nga dispozita e sipërcituar është e qartë se në rastet kur fëmija lind nga një nënë e cila

plotëson kriteret e mësipërme (e martuar, me martesë të zgjidhur, me martesë të shpallur të pavlefshme) ndodhemi para rastit të përcaktimit të përbërësit të gjëndjes civile « atësia » mbi bazën e prezumimit, ndërsa kur fëmija lind nga një nënë e pamartuar ndodhemi para rastit të caktimit të përbërësit të gjëndjes civile sipas “veprimeve të vetë personit”.

Ndërkohë që në rastet që egzistojnë kushtet ku atësia e fëmijës nuk është bashkëshorti i nënës por një person tjetër ligji ka parashikuar se :

Burri, që sipas nenit 180 të këtij Kodi, prezumohet se është atë i një fëmijë, mund të kundërshtojë atësinë e këtij fëmijë.

Padia për kundërshtimin e atësisë ngrihet kundër fëmijës, i cili përfaqësohet nga nëna. Kur nëna është në pamundësi dhe fëmija është i mitur, i caktohet një kujdestar i posaçëm nga gjykata.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti, nga data që burri ka marrë dijeni për lindjen e fëmijës.

Vlen të theksohet fakti se ligji e lidh të drejtën e ngritjessë padisë me një afat pas të cilit nuk mund ti drejtohesh gjykatës në bazë të parashikimeve të mësipërme.

Theksojme se raste të tilla janë të rralla dhe procese mjaft delikate.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS



FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË BASH- KISË SË TIRANËS, PËR PËRFITIMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA

Bashkia e Tiranës ka filluar nga zbatimi i një programi të ri, për t'u ardhur në ndihmë familjeve me pak të ardhura, për të përfituar banesa sociale me qira të ulët.

Në mbështetje të ligjit Nr. 9232, datë 13.05.2004 për "Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane" (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 53, datë 28.01.2005 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale me qira"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.814, datë 03.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit"; Manualit të Banesave

Sociale me Qira të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit si dhe Urdhëresës së Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr. 821, datë 23.07.2010 mbi "Procedurat, të cilat duhet të ndiqen dhe dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar nga programi i banesave sociale me qira", Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social dhe Njësia e Zbatimit të Projekteve pranë Bashkisë së Tiranës, ka shpërndarë njoftime për të gjithë qytetarët/familjet që kanë paraqitur pranë zyrave përkatëse në bashki, kërkesën për strehim në Pro-



gramin e Banesave Sociale më Qira, të aplikojnë për të përfituar nga trajtimi me këtë program në kuadër të Projektit “Ndërtimi i Banesave me Qëllim Social” për miratimin e listës së përfituesve për shpërndarjen e banesave sociale, duke dorëzuar pranë Sektorit të Informimit Qytetar dokumentacionin përkatës të cilin Bashkia e Tiranës e ka dërguar pranë këtyre familjeve dhe e ka shpallur.

Ndër të gjithë aplikantët do të jenë fitues ata që kanë fituar pikët maksimale sipas sistemit të pikëzimit që do miratohet me

vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës.

DOKUMENTET SHOQËRUESE PËR APLIKIMIN PËR BANESA SOCIALE

I. GJENDJA FAMILJARE

- Çertifikata e lindjes e aplikantit dhe çertifikata familjare e tre muajve të fundit nga institucionet përkatëse.
- Kopje e noterizuar e dokumenteve të identifikimit (pasa-portës, çertifikatës personale).
- Vërtetim që vërteton se jeni banor në njësinë bashkiake, ku është paraqitur kërkesa.
- Në rastin e çifteve të divorcuara që kanë një fëmijë në kujdestari, vendimin gjyqësor për kujdestarinë e fëmijës.
- Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për çdo pjesëtar të punësuar ose të vetëpunësuar sipas kolonës 4 të nenit I të deklaratës. Vërtetimi duhet të shoqërohet me librezën e punësimit ose me



kontratën e punësimit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

II. STATUSI I STREHIMIT

- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme që nuk ka të dhëna mbi pronësinë e shtëpisë në emër të personit që kërkon strehim dhe pjesëtarëve të familjes së tij.

- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme për sipërfaqen e pronës që zotërohet nga familja ose nga ndonjëri prej pjesëtarëve të saj.

- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme mbi disponueshmërinë e pronësisë së çdo godine, e cila mund të përdoret si një godinë banimi.

- Nëse është me qira, kontrata e qirasë e nënshkruar në prani të Noterit.

- Nëse jetoni në një banesë me kushte jo të mira ose që rrezikon shembjen, kopja origjinale e vërtetimit të lëshuar nga Shërbimet Teknike të Bashkisë.



- Në rastin e çiftëve të reja, aktin e martesës dhe certifikatat për llogaritjen e moshës totale.

- Në rast lëvizjeje për arsye punësimi, vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme e vendit të origjinës, që në emrin e aplikantit nuk ka asnjë të dhënë të ndonjë prone të regjistruar e cila mund të përdoret si banesë.

III. TË ARDHURAT E FAMILJES

- Dokumenti përkatës nga punëdhënësi i cili deklaron poz-



cionin dhe të ardhurat e aplikantit dhe atë të çdo pjesëtari tjetër të familjes që është në gjendje pune.

- Dokument nga organet e taksave dhe ato të sigurimeve shoqërore për kontributet e depozituara, kur një prej pjesëtarëve të familjes është i vetëpunësuar.

- Vërtetim i punësimit të rastit (orët e punës dhe të ardhurat për një vit).

- Vërtetim të shumës së pagesës nga Zyra e Ndihmës dhe

Kujdesit Bashkiak, për pjesëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike për personat me aftësi të kufizuara.

- Vërtetim të shumës së pagesës nga zyra e punësimit e njësisë bashkiake përkatëse, për personat e përfshirë në programin e pagesës për të papunët.

- Vërtetim të shumës së pagesës nga zyra e punësimit e njësisë bashkiake përkatëse, për personat e përfshirë në programin e ndihmës ekonomike.

- Vërtetim nga organet e sigurimit shoqëror për personat e dalë në pension.

- Deklaratë e të ardhurave të siguruar gjatë vitit të fundit nga:

1. Dypunësimi;
2. Emigracioni;
3. Pasuri e patundshme;
4. Të tjera.

IV. KËRKESË E VEÇANTË PËR STATUSIN E NJË PREJ PJESËTARËVE TË

FAMILJES

Në rastin e individëve me aftësi të kufizuara, dokumentacionin zyrtar që verifikon statusin e:

- I verbër i grupit të parë
- Invalid paraplegjik dhe tetra-plegjik
- Invalid i punës
- Invalid i Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare
- Jetim

V. DEKLARATË PERSONALE E NOTERIZUAR SIPAS MODELIT TË PËRCAKTUAR NE MANUALIN PËR MENAXHIMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA.

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time personale dhe në praninë e noterit, unë deklaroj si më poshtë:

1. I gjithë informacioni i dhënë në formularin KËRKESË PËR BANESË SOCIALE është i vërtetë.
2. Në rast se zgjidhem për banesë sociale, unë pranoj kryerjen e një inspektimi të banesës

ku unë jetoj, si edhe verifikimin e të gjithë informacionit të dhënë.

3. Unë jam i vetëdijshëm që, për çdo informacion të rremë, mua dhe familjes time do të na hiqet e drejta për të përfituar banesë sociale.

4. Unë jam i vetëdijshëm që, në rast se unë jam i përshtatshëm për të përfituar banesë sociale, zyra e strehimit pranë bashkisë, bazuar në të dhënat mbi të ardhurat e familjes, mund të më ofrojë një formë alternative të strehimit, ndryshe nga ajo që unë kam kërkuar në KAPITULLIN IV të këtij formulari.



Nënshkruar në _____, më _____

Deklaruesi: (Emri/Mbiemri/Nënshkrimi) _____

Noter: (Emri/Mbiemri/Nënshkrimi) _____
(Pulla postare dhe pulla e thatë)

Elvira Dervishi
Këshilltare e Programit, TLAS



Histori e Vërtetë,

F. K. ishte shumë i shqetësuar kur u paraqit pranë TLAS, sepse kishte konstatuar që vajza e tij 16 vjeçare, mbas transferimit të të dhënave të gjendjes civile nga një komunë në veri të Shqipërisë, në një zyrë të gjendjes civile të Tiranës, figuronte si djalë. Ajo paraqitej në regjistër si “i biri” dhe gjinia ishte “mashkullore”.

Pasaktësitë ishin krijuar për disa arsye:

Së pari, deklarimin e lindjes së vajzës e kishte bërë gjyshi i saj dhe punonjësi i gjendjes civile të komunës së asaj kohe, kishte vendosur një emër të gjinisë mashkullore (variant i një emri të gjinisë femërore), megjithëse tek të dhënat e tjera ishte vendosur “e bija” dhe gjinia ishte shënuar “femërore”. Ky ishte gabimi i parë.

Së dyti, gjatë procesit të transferimit të dokumentave të



gjendjes civile nga komuna në veri të Shqipërisë, në një zyrë të gjendjes civile të Tiranës, në vitin 2002, krahas emrit të vajzës (që dukej si emër i gjinisë mashkullore), në rubrikën e lidhjes me kryefamiljarin, ishte bërë shënimi “i biri” dhe gjinia ishte shënuar “mashkullore”.

Për vetë faktin që dokumentacioni që shkëmbehej ndërmjet zyrave të gjendjes civile gjatë transferimit, nuk ruhet për një kohë të gjatë, nuk është e qartë se në cilën zyrë të gjendjes civile është bërë gabimi. (Tani,

që është bërë kompjuterizimi i të dhënave të gjendjes civile, transferimi bëhet direkt në kompjuter dhe shmangen gabimet e shkrimit të punonjësve të gjendjes civile, për shkak të pakujdesisë).

F. K. ishte paraqitur shumë herë në zyrën e gjendjes civile të Tiranës, por atje nuk i tregohej rruga që duhet të ndiqte për të korrigjuar të dhënat e vajzës së tij. Mbas takimit të F. K. me TLAS, kontaktuam në telefon me punonjësën e gjendjes civile të komunës, ku qytetari kishte patur vendregjistrimin dhe u

sqarua ai për gabimet e bëra dhe rrugën që duhej ndjekur për korrigjimin e tyre. Nga ky punonjës u kërkuar:

1. Të lëshonte një certifikatë personale të vajzës me të dhënat që figuronin në regjistrë, pra me emrin e gabuar (të gjinisë mashkullore), dhe shënimet “e bija” dhe “femër”. Në certifikatë të shënohej që lëshohej për efekt “korrigjimi gabimi material”.
2. Të bënte një fotokopje të vërtetuar të fletës familjare të F. K.

Me këto dy dokumenta, zyra e gjendjes civile të Tiranës bëri korrigjimin e të dhënave të deformuara gjatë transferimit të gjendjes civile, pra u korrigjua rubrika “lidhja me kryefamiljarin”, nga “i biri” në “e bija” dhe gjinia u korrigjua, nga “mashkullore”, në “femërore”. Mbetej pa korrigjuar tashmë, vetëm emri i vajzës.

Për të ndryshuar emrin, në mënyrë që ai të kishte një formë normale femërore, u shfrytëzua një nen i ligjit “Për gjendjen



civile”, sipas të cilit, çdo qytetar mund të ndryshojë emrin e tij, kundrejt një tarife. Në këtë mënyrë, u realizua korrigjimi i gabimeve të bëra në zyrat e gjendjes civile dhe tashmë vajza e F. K. nuk figuron më si djalë, në gjendjen civile.

Elvira Dervishi
Këshilltare e Programit, TLAS

Histori e Vertete

Ç.D. është babai i pesë fëmijëve. Nga këta pesë fëmijë, është i regjistruar në gjendjen civile vetëm fëmija më i vogël. Katër të tjerët nuk janë të regjistruar. Më i madhi është 10 vjeç dhe më i vogli është 5 vjeç. Familja e Ç.D. jetonte dikur në një komunë në juglindje të Shqipërisë dhe atje lindën këta katër fëmijë. Nëna e fëmijëve nuk arriti të shtrohej në spital, për shkak se fshati është në një zonë të thellë malore dhe fëmijët lindën





në kushte shtëpie. Mbas lindjes së fëmijëve, nëna nuk njoftoi ndonjë nga punonjësit e shëndetësisë së komunës, që janë të autorizuar të lëshojnë dokument zyrtar, që vërteton lindjen e fëmijës dhe jep të dhënat bazë për mbajtjen e aktit të lindjes në zyrën e gjendjes civile. Në mungesë të këtyre dokumentave, këta fëmijë mbetën të paregjistruar në gjendjen civile dhe regjistrimi i tyre mund të bëhej vetëm nëpërmjet vërtetimit të faktit të lindjes në një proces gjyqësor.

Në vitin 2006 familja u transferua në një bashki në qendër të Shqipërisë, por nuk bëri shpërnguljen e të dhënave të gjendjes civile. Në vitin 2009 nëna braktisi familjen, duke i lënë fëmijët nën kujdesjen e bashkëshortit Ç.D., në kushtet e një varfërie të madhe. Babai i fëmijëve bëri shumë përpjekje për regjistrimin e tyre, por nuk ai nuk ka as mundësitë financiare dhe as shkollimin e nevojshëm për të ndjekur të gjitha procedurat. Kur ai u paraqit në TLAS, ne filluam nga puna për zgjidhjen hap pas hapi të problemeve.

Fillimisht realizuam transferimin e dokumentave të gjendjes civile të familjes, nga vendbanimi i mëparshëm në komunën në juglindje të Shqipërisë, në bashkinë në qendër të Shqipërisë, ku jeton tani familja. Më tej TLAS u angazhua për grumbullimin e provave të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve, nëpërmjet një procesi gjyqësor. Kështu, u morrën këto dokumenta:

1. Vërtetime nga ambulanca e fshatit të vendbanimit të mëparshëm, për ndjekjen e vazhdueshme të ecurisë së fëmijëve;

2. Librezat e vaksinave të fëmijëve, të lëshuara nga ambulanca e fshatit të vendbanimit të mëparshëm, ku janë shënuar edhe datat e lindjes së fëmijëve;

3. Vërtetim nga kryeplaku i fshatit të vendbanimit të mëparshëm, që fëmijët kanë qënë të paregjistruar dhe që kanë banuar vazhdimisht me prindërit e tyre;

4. Vërtetim nga Kryetari i Rajonit të vendbanimit të tanishëm, që fëmijët kanë jetuar dhe jetojnë vazhdimisht me babain e tyre;

5. Vërtetim nga shkolla për ndjekjen e mësimave nga djali i madh.

Në bazë të këtyre dokumentave, avokati i TLAS ka përga-

titur kërkesën për gjykatë, në emër të babait të fëmijëve dhe jemi në pritje të fillimit të procesit gjyqësor, që do të mundësojë vërtetimin e faktit të lindjes për secilin prej katër fëmijëve. Duke qënë të regjistruar, këta fëmijë mund të marrin të gjithë ndihmën e nevojshme financiare, si fëmijë të braktisur nga nëna.

Elvira Dervishi
Këshilltare e Programit, TLAS



Histori e vërtetë Rasti I klientes E.H.

Pranë zyrës së Shërbimit Ligjor Falas u paraqit një kliente me inicialet E.H.

Zyrën tonë ia kishte rekomanduar një kolege e një organizate tjetër. Ajo l përkiste komunitetit Rom dhe kërkoi mbrojtje ligjore për shkak se ajo nuk mund të ushtronte lirisht përgjegjësinë prindërore për fëmijën e saj të mitur.



Klientja kishte lindur një vajzë nga bashkëjetesa me atë që ajo e konsideronte ish-bashkëshortin e saj por që në fakt ato nuk kishin lidhur martesën ligjore. Kjo gjë ndodh shpesh në komunitetin Rom, pasi për shkak të njohurive të tyre ata mendojnë se duke jetuar së bashku, dy njerëz konsiderohen të martuar pa ditur që në fakt ata ndërkohë nuk janë duke konsumuar martesën ligjore si dhe të drejtat dhe detyrimet që vijnë prej saj.

Në rastin e klientes tonë, ish-bashkëjetuesi i saj dhe njëkohësisht babai i fëmijës nuk jetonte më me të. Ata kishin realizuar ndarjen faktike nga njëri-tjetri, duke zgjidhur dhe pasojat e kësaj ndarjeje sipas mënyrës së tyre.

Klientja jonë që prej kohës së ndarjes, ishte kujdesur dhe kishte ushtruar e vetme përgjegjësinë prindërore pasi babai i fëmijës nuk ishte interesuar më kurrë për të dhe për fëmijën, duke ju shmangur kështu të gjitha detyrimeve që lindnin për të në kuptim

të ligjit. Ai gjithashtu në rrethana të panjohura nga klientja kishte mundur të regjistronte fëmijën pranë zyrës së gjendjes civile ku kishte gjendjen e tij familjare.

Në këto kushte klientja E.H e kishte shumë të vështirë të kryente veprime në emër dhe për llogari të fëmijës së saj, i cili nuk ishte i regjistruar në gjendjen e saj familjare dhe për të cilën faktikisht kujdesej plotësisht e vetme.

Ajo gjithashtu, siguronte jetesën për fëmijën e vogël dhe nënën e saj të moshuar duke punuar si pastruese dhe duke mos patur kurrë asnjë lloj kontributi financiar nga prindi tjetër për fëmijën. Në këto kushte rasti i kësaj klienteje paraqiste disa probleme për zgjidhje dhe zgjidhja e vetme ishte ajo gjyqësore.

Avokati i Shërbimit Ligjor Falas pasi informoi klienten për të drejtat që i lindnin asaj nga kjo situatë filloi nga puna për sigurimin e provave që do të duheshin në procesin gjyqësor. Me ndërhyrjen e Shërbimit Lig-

jor Falas ne mundëm që të siguronim një certifikatë të fëmijës, që ishte pjesa e vështirë në këtë proces, pasi certifikatën nuk mund ta merrte klientja jonë, për shkakun e regjistrimit të fëmijës në gjendjen familjare të ish bashkëjetuesit të saj. Më pas u proçedua me dokumentat e tjera të nevojshme për procesin gjyqësor.

Pas hartimit të kërkesë padisë dhe konkretizimit të të drejtave të kërkuases çështja filloi gjykimin pranë Gjykatës së Rrethit



Gjyqësor Tiranë ku dhe po vazhdon gjykimi. Në fillim ky gjykim u realizua me praninë e vetë klientes sonë, por më pas ardhja e saj në proces u vështirësua nga kushtet e saj shëndetësore. Avokatët tanë u kujdesën që nëpërmjet aktit të përfaqësimit ta ndiqnin më pas çështjen edhe pa praninë e klientes E.H në proces. Çështja tashmë është në rrugën e zgjidhjes dhe në favor të klientes sonë pasi dhe në procesin gjyqësor babai i fëmijës ka refuzuar vazhdimisht të marrë pjesë dhe u ka shfaqur i

pa interesuar lidhur me zgjidhjen e pasojave për të drejtat e fëmijës së tij. Në këto kushte çështja po merr zgjidhje në favor të pretendimeve të klientes sonë dhe në favor mbi të gjitha të parimit të interesit më të lartë të fëmijës. Po mundohemi gjithashtu ta mbyllim sa më shpejt procesin gjyqësor në mënyrë që nëna e saj, klientja E.H të ketë lehtësi në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për shkollimin e vajzë, duke qënë se ajo është në moshën e duhur për të filluar klasën e parë, si dhe çdo lehtësi tjetër që do ti vijë asaj nga zgjidhja e çështjes.



Anisa Metalla
Avokate/këshilltare paraligjore,
TLAS

Histori e Vërtetë Rasti i klientes S.H

Klientja S.H. u drejtua në zyrat e Shërbimit Ligjor Falas, për të marrë ndihmë ligjore përse i përket të drejtës së saj për të përfituar pension pleqërie. Rasti i saj u dëgjua me mjaft vëmendje dhe u orientua për zgjidhjen e duhur nga avokatët e TLAS.

Klientja i ka drejtuar një kërkesë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për të përfituar pension pleqërie, e cila i është refuzuar prej Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, me arsyetimin se klientja figuron në regjistrin themeltar të vjetërsisë në punë me emër ndryshe, ndërsa mbiemri është i njëjti. Inicialet e saj janë S.H. ndërkohë rezulton me inicialet D.H. Klientja në certifikatën e lindjes së gjendjes civile, rezulton me emrin S.H. Në këtë rast duhej bërë njohja në rrugë ligjore duke qenë se bëhej fjalë për të njëjtin person. Klientja S.H. ka filluar punën në kooperativën bujqësore në vitin



1967, siç rezulton nga vërtetimi “Për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore”, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Që prej vitit 1990 deri në 2007, ajo është siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi, siç vërtetohet nga vërtetimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore sipas të dhënave të regjistrit themeltar.

Dokumenti vërtetim “Për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore”, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i vitit 2008, përmban pasaktësi të emrit të klientes S.H.



bazuar në regjistrin themeltar të vjetërsisë në punë, ndërkohë sipas çertifikatës së lindjes së gjendjes civile të Komunës emri i saj i saktë është S.H.

Regjistri i Institutit të Sigurimeve Shoqërore ka dhe një pasaktësi tjetër pasi nuk përmban të gjitha vitet e punës që klientja ka punuar dhe shumë vite të punës nuk janë shënuar.

E vetmja rrugë për t'i dhënë zgjidhje të drejtë dhe ligjore këtij problemi është vërtetimi i faktit se klientja me inicialet S.H. është i njëjti person që mban inicialet D.H. dhe se ajo realisht ka punuar në kooperativën bujqësore

nga viti 1967 deri në vitin 1990. Kjo zgjidhje jepet në K.Pr.C.

Sipas nenit 388 të K. Pr.C paragrafi i tretë, kërkohet që “kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që e vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë. Kërkesa paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banim kërkuesi. Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet korigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni”.

Pasaktësia e këtij vërtetimi do të provohet me prova shkrese –me vërtetimin “Për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore”, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, e vitit 2008, vërtetimin për të vetëpunësuarit në bu-

jqësi e lëshuar prej Instituti i Sigurimeve Shoqërore e vitit 2007, çertifikatën e lindjes së gjendjes civile të Komunës, vërtetimin e Komunës, në të cilën kryetari i Komunës vërteton se klientja S.H. është banore e vjetër në këtë Komunë, vërtetimin e kryetarit të fshatit, ku ajo banon, ku deklarohet i njëjti fakt, se klientja është banore e këtij fshati. Këtë pretendim ajo e bazon dhe e provon dhe me thëniet e majft dëshmitarëve, të cilët kanë punuar me të.

Nga këto prova rezulton plotësisht se vërtetimi për vjetërsinë në punë për ish-anëtarët e ko-

operativave bujqësore”, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dt 2008, përmban pasaktësi në emrin e klientes dhe të viteve të saj të punës në kooperativë.

Klientja nuk mund ta provojë pretendimin në rrugë tjetër veç asaj gjyqësore dhe nga vërtetimi i tij rrjedhin pasoja juridike që lidhen me efektet e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të saj dhe interesave të ligjshme.

Anisa Metalla
Avokate/këshilltare paraligjore,
TLAS



Aktiviteti Street Law

Një ndër aktivitet që organizon Sherbimi Ligjor Falas është dhe street law. Një aktivitet që organizohet tërësisht nga studentët që janë pjesë e programit "Internship Students" pranë Shërbimit Ligjor Falas.

Ne periudhën janar-qershor janë realizuar gjithësej 10 street law nëpër zona të ndryshme të vëndit. Zonat e përzgjedhura për këtë aktivitet janë zona që spikasin për problemet e shumta ligjore dhe ekonomike. Kryesisht

janë zonat periferike të Tiranës, Lushnjes, Elbasanit, Durrësit, ku është përqëndruar komuniteti rom, por që nuk kufizohet vetëm me këtë komunitet pasi tagërgrupi që zyra iu ofron shërbime janë grupet vulnerabël.

Veprimtaria e studenteve në këto zona përqëndrohet në dhënien e informacionit në lidhje me zyrën tonë dhe fushën e veprimtarisë së saj. Infomacioni shpërndahet në forma të ndryshme duke filluar nga ngjitja e posterave reklamues për zyrën, shpërndarja e fletëpalosjeve apo dhënia në mënyrë verbale e informacionit duke kontaktuar personalisht me qytetarët.

Në këto zona jo vetëm që informohet, por bëhet edhe piketimi e marrja në shënim e problemeve të ndryshme ligjore që kanë qytetarët, që mund të gjejnë zgjidhje pranë kësaj zyre. Këto probleme transmetohen tek avokatët që investohen më vonë në dhënien e zgjidhjeve ligjore.

Kryesisht problemet ligjore janë mos rregjistrimi i fëmijëve, që iu heq të drejtën bazike për të



qenë të indetifikuar si persona dhe që gjithashtu passjell mungesën e aksesit në shërbimet shëndetësore apo arsimore, tranferime nga qytetet e ndryshme apo zgjidhja e martesës së personave që nuk kanë mundësi ekonomike që të perballojnë shpenzimet gjyqësore etj.

Ky aktivitet konsiderohet një nga aktivitetet e rëndësishme dhe të sukseshme të kësaj zyre duke qënë se është një kontakt i drejpërdrejtë i kësaj zyre me personat në nevojë.

Studentet pjesëmarrës janë: Brisilda Taco, Lurand Llagami, Stela Shkarpa, Migena Meto, Fabiola Bregu.

Rina Pero
Asistent Avokate

Përsosja e sistemit për ofrimin e Ndhmës Juridike¹ kusht parësor për rritjen e aksesit në drejtësi të individëve në nevojë

Me mbështetjen e Civil Rights Defenders, CRD, TLAS organizoi një tryezë të rrumbullakët në Hotel Tirana me synim:

- Përmirësimin e funksionimit të sistemi të Ndhmës Juridike ;

1 Kur themi Ndhmë Juridike nënkuptojmë shërbimin ligjor falas për persona në nevojë



Promovimin e këtij sistemi që në thelb nënkupton rritjen e aksesit në dejtësi për shtresat vulnerabel; Rritjen e efikasitetit të Ndihmës Juridike përmes zbatimit të Ligjit "Për Ndihmën Juridike" dhe ofrimit të modelit më të përshtatshëm dhe më cilësor.

- Ndërtimin i sistemit efikas të Ndihmës Juridike që ndikon drejtëpërdrejt në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, në përmirësimin e sistemit demokratik të qeverisjes dhe rritjen e aksesit në dejtësi.

- Ndërtimin i Modelit të ofrimit të Ndihmës Juridike që synon të strukturojë anën organizative, menaxheriale edhe atë profesionale në 4 zona të targetuara në vitin e parë dhe në 4 zona të tjera të targetuara në vitin e dytë do të shërbej për ta aplikuar më suksesshëm në pjesën tjetër të vendit.

- Sigurimin i një niveli më të lartë cilësor shërbimi përmes trajnimit të trajnerëve dhe avokatëve për aplikantët që plotësojnë kriteret e përfitimit.

- Hartimin dhe miratimin i politikave, procedurave dhe akteve nga Komisioni i Ndihmës Juridike për:

1. Kriteret e perzgjedhjes dhe kushtet e kontraktimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmën juridike;

2. standartet dhe kriteret e perzgjedhjes së aplikantëve për përfitimin e ndihmës juridike;

3. Formularët e aplikimit



dhe procedurat e ankimimit;

4. Kurrikulumi i trajnimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike;

5. Kriteret e pranimit të çështjeve/ rasteve sipas llojit;

6. Standartet e cilësisë dhe kontrollit;

7. Politikat e rimbursimit të avokatëve privatë;

8. Përcaktimi i indikatorëve të monitorimit dhe kontrollit.

- Ndërgjegjësimin, angazhimin dhe mbështetjen për zbatimin e ligjit të Ndihmës Juridike do të rritet ndjeshëm si në nivelin vendim marrës, ashtu edhe në nivelin lokal ku do të veprojnë avokatët.

- Rritjen e rolit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë në sistemin e ndihmës ligjore dhe në përmbushjen prej saj të detyrimeve që lidhen me nevojën dhe dobinë e kriterizimit, monitorimit

dhe klasifikimit të avokatëve sipas llojeve të fushave specifike të shërbimit të avokatisë.

- Rritjen e ndikimit në sigurimin e Fondit të nevojshëm për të plotësuar nevojat e aplikantëve për ndihmë juridike, etj.

Raimonda BOZO
Drejtoresh Ekzekutive e TLAS







SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)
Rruga "Sami Frashëri"
4 kullat, Seksioni 3, Ap. 1A, Tirana, Albania
Tel/Fax: +355 4 2258 442
Tel: +355 4 2253 114
Kutia Postare 69
E-mail: tlas@tlas.org.al
www.tlas.org.al

Design: ederstudio.com
Cel: 069 20 92 922

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 3 / 2010

TLAS

